

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Përgjegjës Sektori	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	08.03.2023	22.03.2023

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Përgjegjës Sektori , në Sektorin Special të Sigurisë Kibernetike, në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak Nr.6601, Shtabi i Përgjithëm i Forcave të Armatosura.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 08.03.2023
8. Data e mbylljes së aplikimit: 22.03.2023
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

a. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

b. Grada/Titulli: Civil/Përgjegjës sektori

c. Arsimi : Të zotërojë diplomë Bachelor në inxhinieri për TIK, Shkencat Kompjuterike, Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit ose barazvlefshme me to si dhe Master Shkencor për shkenca kompjuterike/sigurinë kibernetike.

d. Kualifikimi: Të zotërojë certifikimin CISM (Certified Information Security Management), CRISC (Certified Risk Information Security Control), ose CISSP (Certified Information Systems Security Professional).

e. Trajnimi: Të zotërojë [CompTIA Security+](#) certifikatë për TI professional.

f. Eksperienca në Punë: Jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë në mjediset e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit duke përfshirë njohuri mbi trajtimin e incidenteve, angazhimin në përgjigje ndaj incidenteve/eventeve të sigurisë duke qenë pjesë e strukturave të

ndërlidhjes në FA ose në trajtimin e incidenteve/eventeve të sigurisë së shërbimeve në rrjetet kompjuterike. Eksperiencë të mëparshme në menaxhimin e infrastrukturës teknologjike

g. Gjuha e huaj: Anglisht

h. Kërkesa të tjera specifike: Njohuri të strukturave kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë (ENISA, NIST, ITIL, AKCESK, ISO, OWASP etj.) Njohuri mbi aplikacionet software të përdorura nga hackera apo persona keqdashës. Të njohë teknikat e sulmeve ndaj sistemeve të komunikimit dhe informacionit, mjeteve, teknikave dhe procedurave. Njohuri shumë të mira për politikatat, metodat, standardet, proceset, modelet e drejtimit dhe metodat e analizës së rrezikut të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Njohuri të trendeve aktuale të industrive në menaxhimin e rrezikut të informacionit.

i. Niveli i certifikatës së sigurisë: Teper Sekret dhe NATO Secret. Te plotesojë kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015.

12. Përshkrimi i punës:

Deklarimi i pozicionit: Përgjegjës për menaxhimin e Rrezikut në fushën e sigurisë kibernetike. Vazhdimisht, në mënyrë pro aktivë dhe kolektive, angazhon grupin e tij për parashikimin, zvogëlimin dhe parandalimin e rrezikut të kërcënimeve kibernetike të përditësuar si dhe duke hartuar arkitekturën optimale të rrjetit ofron zgjidhje nëpërmjet IAAS (Infrastructure as a Service) Infrastruktura si shërbim dhe PAAS (Platforme as a Service) Platforma si shërbim.

Detyrat kryesore:

1. Siguron mbështetje inxhinierike për sigurinë e lidhjes së rrjetit të teknologjisë së informacionit të FA-së, me shërbimet e internetit në përputhje me standardet, dispozitat, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Përgjigjet për hetimin, zgjidhjen dhe parandalimin e ndërhyrjeve, incidenteve, eventeve apo problematikave të mundshme të sigurisë kibernetike në rrjetet e komunikimit dhe informacionit të FA-së
3. Arkitektkon dhe krijon zgjidhje të sigurta të cilat i përmbahen praktikave më të mira të sigurisë së rrjeteve të FA-së.
4. Mbështet vlerësimin e kontrollit të sigurisë kundrejt shërbimeve të ofruara nga IAAS (Infrastructure as a Service) Infrastruktura si shërbim dhe PAAS (Platforme as a Service) Platforma si shërbim.
5. Mbështet krijimin dhe menaxhimin e një procesi të ri të menaxhimit të rrezikut të sigurisë kibernetike në mënyrë që të miratojë dhe autorizojë kapacitetet e reja të menaxhimit të rrezikut si dhe është përgjegjës për monitorimin e rezultateve të arritura të procesit.
6. Krijon dhe harton dokumentacionin e nevojshëm, duke përfshirë udhëzime të përditësuar për zbatim, të miratuara sipas shkallës hierarkike si dhe ndjek hapat e procesit të autorizimit që përfshijnë dokumentacionin e kontrollit të objektivave, se si ato arrihen dhe se si ato monitorohen.
7. Rishikon dhe përditëson të gjithë dokumentacionin e Menaxhimit të Rrezikut për të siguruar se i gjithë dokumentacioni është në përshtatshmëri me pozicionin aktual të operacionalitetit të NJUSK-ut.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit

profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.